



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: HYRJE NË TRASHËGIMI KULTURORE

Pedagogu: PhD.c. Edlira Çaushti

Ngarkesa: 6 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)

Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)

Programi i studimit: Bachelor

Viti/ Semestri: I/I

EKSTRAKT

Qëllimi kryesor i programit është diskutimi i përmbajtjes dhe konceptit të Trashëgimisë Kulturore. Nga ana tjetër, një modul i rëndësishëm i programit i kushtohet vështrimit të strukturave aktuale të Trashëgimisë Kulturore jo vetëm në Shqipëri, por edhe strukturat e Trashëgimisë Kulturore Botërore. Tema të tjera të rëndësishme përfshijnë njohja dhe diskutimi i konventave nderkombetare të TK Botërore të ratifikuara nga Shqipëria. Ligji i Trashëgimisë kulturore shqiptare si dhe aktet nenligjore apo amendamentet që e kanë pasuruar ndër vite. Një vend të rëndësishëm do të zërë njohja dhe diskutimet mbi parimet e përgjithshme të praktikave të restaurimit arkitektonik si dhe restaurimit të objekte të Trashëgimisë Kulturore dhe Veprave të artit. Po ashtu rëndësi do t'i jepet diskutimit të konceptit të peisazhit kulturor dhe Trashëgimisë Natyrore dhe pasurisë mjedisore të vendit. Trashëgimia kulturore jo materiale do të jetë po ashtu objekt diskutimi përgjatë një leksioni, ku do të sillen shembuj të kategorive të ndryshme të kësaj pasurie në vend. Të tjera tema do të lidhen me vendin e TK në shoqërinë shqiptare si dhe vendin e TB shqiptare në listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore.

TEMAT:

LEKSION 1. Koncepti dhe strukturat e Trashëgimisë Kulturore

LEKSION 2. Strukturat dhe administrimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore.

LEKSION 3. Konventa të Pasurive Kulturore dhe Natyrore, të ratifikuara nga shteti shqiptar.

LEKSION 4. Konventa e UNESCO 1972 për Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore.

LEKSION 5. Trashëgimia Kulturore materiale dhe kategoritë e saj.

LEKSION 6. Ligji shqiptar i Trashëgimise Kulturore dhe amendamente te tij.

LEKSION 7. Koncepti restaurimit të Trashëgimisë Kulturore dhe praktikat e restaurimit arkitektonik

LEKSION 8. Koncepti restaurimit të Trashëgimisë Kulturore dhe praktikat e restaurimit të objekteve te trashëgimise dhe veprave te artit.

LEKSION 9. Parime themelore të konservimit dhe karta shqiptare e restaurimit.

LEKSION 10. Trashegimia Natyrore dhe pasurite e mjedisit.

LEKSION 11. Peisazhi kulturor dhe ligji per zonat e mbrojtura natyrore.

LEKSION 12. Trashegimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor.

LEKSION 13. Trashegimia Kulturore jo materiale.

LEKSION 14. Trashegimia Kulturore shqiptare ne listen e Trashëgisë Kulturore Botërore.

LEKSION 15. Trashegimia Kulturore dhe vendi i saj në shoqërinë e sotme shqiptare.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)
Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)
25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT: Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)
20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri
40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

1. <http://www.kultura.gov.al/>
2. <http://en.unesco.org/> ; <http://www.icomos.org/en/> ; <http://www.iucn.org/>
3. HTTP://PORTAL.UNESCO.ORG/EN/EV.PHP-URL_ID=13637&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.HTML ;
4. <HTTP://WWW.UNESCO.ORG/NEW/EN/CULTURE/THEMES/UNDERWATER-CULTURAL-HERITAGE/2001-CONVENTION/OFFICIAL-TEXT/> ;
5. <HTTP://WWW.UNESCO.ORG/CULTURE/ICH/EN/CONVENTION>
6. <http://whc.unesco.org/en/conventiontext/>
7. Bejko, L., P. Qirjazi, V. Tole 2009, *Trashëgimia jonë kulturore*. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit. Tiranë.
8. Riza, E., *Teoria dhe Praktika e Restaurimit Arkitektonik*, Tiranë.

9. Franceschi, S., L. Germani, M. Pasquini, E. Ulivi 2003 *Il Progetto di Restauro: protocolli operativi*. Alinea Editrice.